

Lënda: Kthim përgjigje

## **Z. Genci Malile**

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar me nr. 3254, datë 14.04.2023, ju sqarojmë si më poshtë:

Bazuar në librezën e punës, për periudhën 16.08.1975 - 01.11.1975, keni punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme, Kombinati Metalurgjik Elbasan, me profesion inxhinier elektrik stazhier. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 12.08.2005 “Për caktimin e pagave referuese për caktimin e pensioneve”, për efekt të llogaritjes së pensionit, kjo periudhë është marrë me pagë referuese 3 288 lekë sipas tabelës nr. 2, kodi b 6.

Për periudhën 01.11.1975 - 23.03.1976, keni punuar pranë Uzinës së Gizës, Kombinati Metalurgjik Elbasan, me profesion inxhinier elektrik stazhier dhe kjo periudhë është marrë me pagë referuese 3 288 lekë, sipas tabelës nr.2, kodi b 6.

Për periudhën 03.01.1977 - 18.06.1984, keni punuar pranë Uzinës së Çelikut, Kombinati Metalurgjik Elbasan, me profesion inxhinier i diplomuar dhe kjo periudhë është marrë me pagë referuese 4 192 lekë sipas tabelës nr. 2, kodi b 5.

Faleminderit për mirëkuptimin.